



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1581/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, në konfliktin administrativ të paditësit, J.R nga P, Rr. "L.D" nr., kundër të paditurës, K. sh.a-Departamenti për Konsumatorë në Prishtinë, për shkak të anulimit të përgjigjes, jashtë seance, me dt.13.10.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, J.R nga P. Anulohet përgjigja me nr.6743, e datës 11.07.2016, e lëshuar nga e paditura, K. sh.a-Departamenti për Konsumatorë në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, J.R nga P, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë me datë 14.10.2016, kundër të paditurës, K. sh.a-Departamenti për Konsumatorë në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga Gjykata, aprovimin e padisë si të drejtë dhe të bazuar, duke e anuluar përgjigjen e të paditurës, me nr.6743 e datës 11.07.2016, dhe paditësi të lirohet nga pagesa e faturës, në emër të rikthimit të humbjeve.

Me përgjigjen e të paditurës, me nr.6743 e datës 11.07.2016, e paditura, në dispozitivin e të njëjtës, ka refuzuar ankesën e paditëses, si të pa bazuar, me konstatimin për arsyet e paraqitura, në arsyetim të kësaj përgjigje.

Paditësi, i pakënaqur me këtë përgjigje, i është drejtuar kësaj Gjykate me padi, duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtës.

Gjykata shqyrtoi aktin e goditur me padi, në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se "Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje". Po ashtu, neni 44.2 i të njëjtit ligj përcakton se "Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare".

Nga akti i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla, për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë e

datës;29.08.2011, që konsistojnë në faktin se me nenin 10 par. 3 të kësaj rregulle është paraparë se: “në të gjitha rastet që nuk përfshihen në nenin 10 par. 2, furnizuesi do të përgjigjet me shkrim parashtruesit të ankesës dhe ajo përgjigje do të përmbajë: 3.1. emrin, shifrën, dhe adresën e konsumatorit, 3.2. arsyetimin dhe bazën ligjore, 3.3. proceset alternative për zgjidhjen e ankesave, nëse konsiderohet e përshtatëshme për rrethanat e ankuesit, 3.4. statusin e ankuesit, përfshirë çdo vendim dhe arsyetim për vendimin e lëshuar nëse është marrë me një vendim ose kërkesë për informacion shtesë ose veprim tjetër të kërkuar që do të shpejtonte procesin e zgjidhjes së kontestit, 3.5. këshillen juridike për konsumatorin mbi të drejtën e tij për të parashtruar ankesë në ZRRE, kundër përgjigjes së dhënë nga furnizuesi”.

Nga akti i kundërshtuar, gjykata vëren se, të njëjtit i mungojnë elementet esenciale të paraqitura më lartë e të cilat janë të përcaktuara me nenin 10 par. 3 të kësaj rregulle dhe të detyrueshme për organin e paditur me rastin e shqyrtimit të kërkesës së konsumatorit dhe dhënjen e një përgjigje sikur në rastin konkret.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së konsumatorit, tani paditëses, K. sh.a-Departamenti për Konsumatorë në Prishtinë, nuk ka vepruar në bazë të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë e datës;29.08.2011, respektivisht nenit 10 par. 3, duke e lëshuar një akt, i cili nuk përmban elementet esenciale të përmendura në nenin e cituar më lartë, e i cili ka qenë i obliguar që të respektojë dispozitat e përcaktuara, e që në kundërshtim me këtë rregull, e ka lëshuar përgjigjen e datës 11.07.2016.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i menjanoj të metat e cekura, të merr një akt të drejtë, e të bazuar në ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, të Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1581/2016, dt.13.10.2017,

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.